



Mbështetur nga Bashkimi Evropian

Në bashkëpunim me



Plani i veprimit i Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore 2022

Janar, 2022

PËRMBATJA

HYRJA	4
PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR TU KONSULTUAR NË KËSHILLIN KONSULTATIV PËR VITIN 2022	1
Katërmujori I	1
Katërmujori II	4
Katërmujori III	6

Shkurtimi	Kuptimi
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MFE	Ministria Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MM	Ministria e Mbrojtjes
MK	Ministria e Kulturës
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSHMS	Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Objekti 3. Përmirësimi i kapaciteteve të AMVV-së dhe MB-së në operimin dhe menaxhimin e KK-së

**Produkti 1: Plani i veprimtimit i Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen
Vendore 2022**

HYRJA

Plani i veprimit i Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore 2022 është instrumenti kryesor i planifikimit dhe i monitorimit të veprimtarisë vjetore të Këshillit dhe ka për qëllim të kontribuojë në përmirësimin e eficiencës dhe efektivitetit të Këshilli Konsultativ në avancimin e procesit të decentralizimit të vendit.

Plani përmban programin e projektakteve ligjore të cilat planifikohen të paraqiten për diskutim në Këshillin Konsultativ gjatë vitit 2022 në përputhje me VKM-në nr. 850, datë 29.12.2021 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2022”. Nga ky program analitik janë analizuar dhe përzgjedhur për Planin e Veprimit të Këshillit Konsultativ për vitin 2022, projektaktet që ndikojnë ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të vetëqeverisjes vendore. Plani është i ndërtuar në tre seksione në periudha katër mujore.

Ky Plan rekomandohet të konsultohet me anëtarët e Këshillit përfaqësues të qeverisë qendrore në mënyrë që të plotësohet me projektaktet (vendime/udhëzime) apo masave që duhet të hartohen/ndërmerren gjatë vitit 2022 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2022, dhe Planit të saj të Veprimit 2020-2022. Plotësimi i Planit me veprimet e mësipërme do të krijojë një instrument të mjaftueshëm për planifikimin dhe monitorimin e veprimtarisë së Këshillit dhe vlerësimin e përmbushjes së qëllimit për të përmirësuar eficiencën dhe efektivitetin e tij në forcimin e qeverisjes së mirë dhe avancimin e procesit të decentralizimit të vendit.

Gjithashtu, ky Plan rekomandohet të konsultohet me anëtarët e Këshillit përfaqësues të qeverisë vendore duke përfshirë propozimeve e njëjësive të vetëqeverisjes vendore që kontribuojnë në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2022, dhe Planit të saj të Veprimit 2020-2022.

PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR TU KONSULTUAR NË KËSHILLIN KONSULTATIV PËR VITIN 2022

Katërmujori I

Nr.	Titulli i projektaktit	Ministria Propozuese	Lloji i Projektaktit	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare PKIE dhe sektoriale	Ndikime të mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore
1	Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare	MB	Projektvendim	Përcaktimi i kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave në lidhje me identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare	Jo	Jo
2	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027	MBZHR	Projektvendim	Projektakti përcakton, vizionin, politikat, Objektivat si dhe masat për realizimin e tyre, shoqëruar me buxhetet përkatëse. Hartohet plani i veprimit që monitorohet bazuar në indikatorët SMART	Po, kapitulli 11	Po. Ekonomike, sociale, mjedisore
3	Për marrjen e masave menaxhuese për ruajtjen e burimeve peshkore	MBZHR	Projektvendim	Marrja e masave menaxhuese nga Shqipëria për ruajtjen e burimeve peshkore, në përputhje edhe me politikën e përbashkët të peshkimit të BE-së	Po, kapitulli 13 "Peshkimi"	Po
4	Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë" (Shqyrtuar ne KK)	MTM	Projektvendim	Mbrotjtje e mëtejshme e faunës së egër në Republikën e Shqipërisë	Jo	Po
5	Për Strukturën e RKFP-së, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyra e mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal dhe qendror, informacioni që duhet regjistruar si dhe afatet e përgatitjes e të raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve	MTM	Projektvendim	Ky projektvendim do të përgatitet në zbatim të pikës 1, të nenit 6, të Ligjit "57/2020, datë 30.4.2020, "Për pyjet dhe komizon mënyrën e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave, përditësimet, shtesat dhe pakësimet që ndodhin mbi fondin pyjor kombëtar.	Po. Pika 2.4 "Mjedisi" f.12.	Jo
6	Për miratimin e kriterëve të vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të bregëzimit të mjeteve lundruese"	MTM	Projektvendim	Akti përcakton kriteret e vendosjes dhe funksionimit të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit në vijën bregdetare dhe vijën bregliqenore të Republikës së Shqipërisë, me synim zhvillimin e kësaj infrastrukture dhe rritjen e aktivitetit të bregëzimit, duke siguruar ruajtjen e standardeve në ofrimin e këtij shërbimi.	Jo	Ky projektakt pritet të krijojë kushte pozitive për zhvillimin e disa aktiviteteve ekonomike, që sigurojnë punësim, të ardhura për buxhetin dhe ekonominë lokale. Për shkak të modelit të

						zhvillimit, supozohet të mos ketë impakt mjedisor.
7	“Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, për vitet 2022 – 2024, në zbatim të strategjisë minerare	MIE	Projektvendim	Projekti përmban drejtimet kryesore të zhvillimit të sektorit mineral për periudhën 3 (tre) vjeçare 2022 –2024. Gjithashtu, në program janë përcaktuar zonat minerare për të cilat do të jepen lejet minerare, përmes procesit të konkurrimit apo procedurave të hapura.	Jo	Jo
8	Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura	MK	Projektvendim	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, pika 3, e nenit 11 Ky projektakt do të përcaktojë masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në situata jonormale siç janë: fatkeqësitë natyrore ose konfliktet e armatosura	Jo	Jo
9	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike përtransportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit’, i ndryshuar(miratuar ne KK)	MAS	Projektvendim	Rishikimi i vendimin nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave lidhur me kategoritë që përfitojnë, procedurat e prokurimit dhe përlogaritjes së masës së shpenzimeve për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit	Jo	Ka efekte financiare për mbulimin e shpenzimeve të transportit ku përfitues janë rreth 32-35 mijënxënës dhe 12 mijë mësues të arsimit parauniversitar
10	Për procedurat e hol lësishme që zbatohen për kalimin e pronësisë dhe modeli i aktit të kalimit të pronësisë të trojeve shtetërore në përdorim	Kryeministr ia	Projektvendim	Në funksion të ecurisë sëveprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve qëburojnë nga ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë	Jo	Po, ndikim sociale
11	Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2022, në njësitë e qeverisjes qendrore	MFE	Projektvendim	Shpërndarja e numrit tëpunonjësve me kontrate të përkohshme,në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2022	Jo	Jo
12	“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2025 (MIRATUAR NE KK 11.02.2022)	MSHMS	Projektvendim	Strategjia do të përcaktojë prioritetet strategjike për periudhën e ardhshme	Jo	Jo
13	“Për krijimin, përbërjen,organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar zhrk për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”(miratuar ne KK 11.02.2022)	Kryeministr ia FSHZH	Projektvendim	Ky projektvendim është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave, kuadrin ligjor në fuqi dhe vjen si nevojë e zbatimit të ligjit nr.102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”		
14	“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2023, shoqëruar me planin e veprimit 2021-2023 sipas formatit IPSIS(MIRATUAR KK 11.02.2022)	MSHMS	Projektvendim	projektakt +relacion+metodologji kostimi+pasaporta e indikatorëve	Jo	Jo

15	"Mjetet qe perdoren per peshkimin çpdpes-argetues dhe menyren e leshimit te autorizimit" me relacion shoqerues	MBZHR	Udhezim	projektakt +relacion. Projektakti është në përputhje me Kushtetutën dhe me nenin 44 të Ligjit nr. 64, datë 31.5.2012 "Për Peshkimin", të ndryshuar	Jo	Jo
16	Per percaktimi e menyres se mbledhjes te te dhenave dhe administrimit te humbjeve nga fatkeqesiteashke me relacionin shoqerues(ardhur per shqyrtim)	MM	Projektvendim	Projektvendimi është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2022.	Jo	Jo

Katërmujori II

Nr.	Titulli i projektaktit	Ministria Propozuese	Lloji i Projektaktit	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare PKIE dhe sektoriale	Ndikime të mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore
1	Për një ndryshim në VKM Nr. 313, datë 15.4.2015 “Për autorizimin dhe kontrollin e veprimtarisë së magazinimit, transferimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil dhe lëndëve piroteknike fishekszjarrë”	MB	Projektvendim	Ky projektvendim propozohet të ndryshohet në kuadër të procesit të deregulimit Lehtësimin i ofrimit të shërbimeve	Jo	Jo
2	Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	MB	Projektligj	Përmirësimi i ligjit kryesisht për çështje të organizimit strukturor. Janë adresuar një sërë problematikash, që konsistojnë në adresimin lidhur me raportet e projektimit të organizatës, strukturës, strategjisë, modelit të organizimit të shërbimi	Jo	Po
3	Vendim i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake”	MB	Projektvendim	Akt nënligjor në zbatim të projektligjit “Për Policinë Bashkiake” akt i propozuar vjen si nevojë e përcaktimit dhe organizimit të Policisë Bashkiake në harmoni me kuadrin e ri ligjor të vetëqeverisjes vendore	Jo	Jo
4	Vendim i Këshillit të Ministrave mbi përcaktimin e uniformës, automjeteve dhe elementët të Policisë Bashkiake.	MB	Projektvendim	Akt nënligjor në zbatim të projektligjit “Për Policinë Bashkiake”	Jo	Jo
5	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 475, datë 30.07.2021 “Për bashkëpunimin e njësisë të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar	MBZHR	Projektvendim	Forcimi i bashkëpunimit mes njësisë dhe shërbimit veterinar në varësi të ministrisë përgjegjëse për Bujqësinë	Jo	Jo
6	“Për përcaktimin e rasteve për dhënien në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”	MTM	Projektvendim	Projektvendimi del në bazë dhe për zbatim të nenit të nenin 5 pika 4, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet “si detyrim ligjor që rrjedh nga ky ligj	Jo	Jo.

7	“Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve shtazore, që nuksynohen për t'u konsumuar nga njeriu”	MTM	Projektvendim	Ky vendim do të zbatohet për nënproduktet kafshëve dhe produktet e përtuara prej tyre të cilat janë përjashtuar nga konsumi njerëzor.	Po	Po, ka ndikim mjedisor, pasi krijohet një mjedis më pak i ndotur nga nënproduktet shtazore
8	“Për përcaktim in e cmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar “	MTM	Projektvendim	Të përcaktojë çmimet dhe tarifat për dhënie dhe marrjen në përdorim të fondit pyjor	Jo	Jo
9	“Për disa shtesa në VKM nr. 452/2012 'Për lëndillet e mbetjeve	MTM	Projektvendim	Objektivi i këtij akti lidhet me nevojën e ngritjes së infrastrukturës së mbetjeve dhe kushteve që duhet të plotësojnë qendrat e transferimit për të qenë funksionale	Jo	Jo
10	Ndryshimi i vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministarve “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar	MAS	Projektvendim	Arsyeja e ndryshimit të këtij vendimi lidhet me synimin e përfshirjes së fëmijëve/nxënësve që u përkasin pakicave kombëtare romë dhe egjiptiane që ndjekin arsimin bazë, nga klasa e parë deri në klasën e 9-të, të përfitojnë bursë financiare/ushqimore, jashtë vlerësimit të kriterëve ekonomike	Po, Kapitulli 26 “Arsimi dhe Kultura”	Ka efekte financiare. Efektet financiare të pritshme nga ky vendim arrijnë në 750.3 milionlekë. Këto efekte financiare nuk kanë parashikuar në PBA 2022-2024 dhe as në buxhetin e parashikuar për vitin 2022
11	“Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 636 datë 26.10.2018 “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore, të kërkuara nga ASHDF, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror e vendor	MSHMBS	Projektvendim	Detyrimë zbatim tëmasave të parashikuara në VKM nr. 659, datë 3.11.2021 “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026	Jo	Po ka ndikime sociale

Katërmujori III

Nr.	Titulli i projektaktit	Ministria Propozuese	Lloji i Projektaktit	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare PKIE dhe sektoriale	Ndikime të mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore
1	Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 dhe plani i veprimit	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët	Projektvendim	Me miratimin e ligjit nr.75/2019“Për rininë”, i cili ka për qëllim përcaktimin e veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të rinjve, doli i nevojshëm hartimi i akteve nënligjore që rrjedhin në bazë dhe për zbatim të tij	Po, Kapitulli 26 "Arsimi dhe kultura	Po
2	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe Planin e tij të Veprimit	MB	Projektvendim	Akt nënligjor në zbatim të ligjit organik nr. 139/2015“Për vetëqeverisjen vendore Ky projektvendim vjen si domosdoshmëri pasi Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, e cila është miratuar me vendimin nr. 691, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave, është parashikuar për periudhën2015-2022 dhe gjithashtu plani i veprimitpër periudhën202-2022 dhe mbaron afati i përcaktuar. Gjithashtu buron edhe Raport “Matrica e Kompetencave të Vetëqeverisjes Vendore	Jo	Po
3	Për këshillat vendorë të sigurisë publike	MB	Projektvendim	Ky projektvendim buron si akt nënligjor në zbatim të ligjit organik nr. 139/2015“Për vetëqeverisjen vendore “nenit 29 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1139, datë 24.12.2020 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në Komunitet 2021 –2026 dhe të planit të veprimit 2021 –2023 ”Ky projektvendim vjen si domosdoshmëri, në mënyrë që roli i KVSPve të jetë efektiv, kontributi i komunitetit në fuqizimin dhe bashkëveprimin me KVSP-të duhet të jetë i unifikuar në 61 bashkitë e vendit	Jo	Po
4	“Mbi përcaktimin e rregullave për zbatimin e sistemit elektronik të regjistrimit dhe raportimit të aktivitetit të peshkimit dhe mbështetjen e anijeve të peshkimit për implementimin e këtij sistemi	MBZHR	Projektvendim	Me këtë akt synohet të përmirësohet raportimi dhe grumbullimi i të dhënave nga aktiviteti i peshkimit si dhe kontrolli, duke ndikuar në një menaxhim më të mirë të resurseve peshkore	Kapitulli 13 “Peshkimi”	Po
5	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8337 datë 30.4.1998, Për kalimin në pronësi të tokës Bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave	MBZHR	Projektligj	Liberalizimi i tregut të pasurive të paluajtshme për shtetasit e BE-së, përbën një detyrë të papërbushur të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit	Po, kapitulli 24	Po
6	“Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare”	MTM	Projektligj	Akti parashikon të garantojë zhvillimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare, sigurimin e mbrojtjes dhe zhvillimit racional, përcaktimin e kufijve të bregut të detit dhe	Jo	Ky projektakt pritet të krijojë premisa për zhvillimin e investimeve në vijën

				brezit të zhvillimeve të qëndrueshme, dhënien e një statusi të veçantë juridik zonës bregdetare, pëaktimin e bregut të detit si pronë e patjetërsueshme, ndalimin e ndërtimeve në bregun e detit dhe disiplinimin e ndërtimeve në brezin e zhvillimeve të kontrolluara në harmoni me bregun e detit		bregdetare dhe rritjen e të ardhurave buxhetore, nga administrimi i tarifave dhe taksave. Një rritje e punësimit parashikohet sirrjedhojë e rritjes së aktiviteteve dhe form alizimit të tyre. Impakti në mjedis mendohet të reduktohet duke q e në se parashikon rritjen e kontrollit mbi aktivitetet në territor.
7	“ Rregullat për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe prodhimeve jo drusore pyjore si dhe kategorizimi i rrugëve autopjore, përdorimi dhe standardet teknike të tyre”	MTM	Projektvendim	Projektvendimi del në bazë dhe për zbatim të nenit të nenin 27 pika 4, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet si detyrim ligjor që rrjedh nga ky ligj.	Jo	Jo
8	Për “Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030	MTM	Projektvendim	Strategjia e re 2020-2030 do të hapë rrugën për të përcaktuar prioritetet e ardhshme kryesore të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Qeverisje, financime dhe menaxhim; aspekte teknike dhe operacionale: përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve UK është i domosdoshëm për të siguruar shërbime më të mira për konsumatorët dhe menaxhim të duhur të aseteve të Shoqërisë UK	Jo	Projektvendimi vete nuk pritet që të ketë ndonjë ndikim në rritjen eshpenezimeve buxhetore për MIE. Por kjo Strategj i ka analizuar Shpenzimet që buxheti i shtet ka bërë për financimin e projekteve të ndryshme nëndërtimin e ujësjellësve ose të infrastrukturës së trajtimit të ujërave të ndotura urbane do të vijojnë të bëhen për sektorin

9	Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar	MIE	Projektligj	Rishikimi i ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në R.Sh." i ndryshuar, për të përfshirë qendrat burimore si institucione arsimore në ndihmë të rritjes së cilësisë së arsimit për personat me aftësi të kufizuara, që mundëson të mësuarit gjatë gjithë jetës, gjithëpërfshirjen dhe reduktimin e braktisjes së shkollës nga personat me aftësi të kufizuara. Rishikimi i ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar synon edhe përshtatjen e tij me procedurat dhe afatet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative	Po -Kapitulli 26 "Arsimi dhe kultura	Për sa i përket efekteve financiare aktualisht nuk mund të llogaritet kostoja
10	Për burimet ujore	Kryeministria	Projektligj	Projektakti synon rregullimin e të gjitha çështjeve që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore, si përcaktimin e organeve përgjegjëse, standardet e cilësisë mjedisore të lidhur me ujërat, çështjet që lidhen me monitorimin e ujërave si dhe rregullimin e çështjeve të lidhura me përdorimin e burimeve ujore me leje apo autorizim	Po, ligji "Për Burimet Ujore" përfshihet në PKIE 2022-2024, për miratim në 2023, si pjesë e Kapitullit 27	Po
11	Për përgatitjen e Planit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin	Kryeministria	Projektvendim	Parashikimi i ligjit nr. 102/2020, "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin"	Kapitulli 22	Jo
12	Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin	MFE	Projektvendim	Detyrim ligjor që rrjedh nga ligji nr. 102/2020, "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin"	Jo	Jo
13	Politika Kombëtare për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin	MFE	Projektvendim	Detyrim ligjor që rrjedh nga ligji nr. 102/2020, "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin"	Jo	Jo
14	Për buxhetin e vitit 2023	MFE	Projektligj	Projektakti i përvitshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar	Jo	Po

15	Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, të rishikuar	MFE	Projektvendim	Projektakt i përvitshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.	Jo	N/A
----	--	-----	---------------	--	----	-----